



**Republika e Kosovës**



**Komuna Vushtrri**

## **Kuvendi Komunal Vushtrri**

**Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkudesje Sociale**

**Raport i punës për periudhën 2010/2011**

Janar 2012

Bazuar në nenin 7.4 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 për organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komuna dhe Planit vjetor të Punës së KK Vushtrisë për vitin 2012, Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ia paraqet Kuvendit të Komunës këtë:

## **RAPORT TË PUNËS**

Bazuar në Planin Vjetor të Punës, kryesuesi i Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në tekstin e mëtejshëm(KKSHPS) paraqet raportin vjetor të punës për vitin 2010 dhe 2011. Raporti bazohet në materiale dhe procesverbale të aprovuara nga komiteti. Raporti i KKSHPS është i ndarë në dy periudha kohore: pjesa e parë periudha e vitit 2010 dhe pjesa e dytë periudha për vitin 2011.

Veprimtarinë e tij KKSHPS e ushtron në përputhje me nenin 8. të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10, i cili përcakton kompetencat e KK.

Gjatë vitit 2010 janë mbajtur tri mbledhje, të cilat i ka ftuar dhe kryesuar kryesuesi, ndërsa mbledhjen e kanë monitoruar: sekretaria e kuvendit, OSBE dhe ICO.

Janë shqyrtuar nëntë pika të rendit të ditës. Pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, sa i përket zhvillimit të shëndetësisë në komunën tonë janë nxjerrë këto rekomandime:

- Respektimi i rregulloreve dhe legjislaturës që ka të bëjë me çështjet shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor së bashku me promovimin e vetëdijes publike dhe këshillim.
- Sigurimin e informacioneve relevante dhe këshillave në çështjet menaxhuese, teknike dhe administrative;
- Përgatitjet profesionale, teknike administrative dhe menaxhuese për planifikim teknik dhe financiar, buxhetin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e tij dhe po ashtu raportimin;
- Planifikimi, furnizimi, menaxhimi dhe plotësimi i listës esenciale të barnave;
- Zonimi i pacientëve në bazë të afërsisë së tyre nga QMF dhe Ambulancave shëndetësore;

Ndërkaq pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës nga çështjet sociale janë nxjerrë këto rekomandime:

- Duhet të angazhohemi në zbatimin e ligjit dhe rregulloreve në lëminë e mirëqenies sociale;
- Duhet të hartohet projekti për ndihmë skamnorëve, sigurimin dhe menaxhimin e mjeteve buxhetore dhe forma tjera të ndihmës;
- Kuvendi komunal në partneritet me biznesin privat të sigurojë lokacione ku do të ndërtoheshin ndërtesa kolektive për të pastrehët;
- Në bashkëpunim me MPMS, kuvendi komunal të sigurojë grante për punësim sezonal për personat që gëzojnë asistencë sociale;

Gjatë vitit 2011 KKSHPS ka mbajtur katër mbledhje. Janë shqyrtuar dymbëdhjetë pika të rendit të ditës. Pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës sa i përket zhvillimit të shëndetësisë në komunën tonë janë nxjerrë këto rekomandime:

- Avancimi i mëtejshëm i sistemit për vlerësimin e punës individuale si dhe sigurimin dhe implementimin e tij nga ana e drejtorëve-administratës;
- Komisioni diciplinor, etiko-profesional dhe komisioni për pushime mjekësore të jetë efikas;
- Organizimi sa më efikas për mbledhjen e të dhënave;
- Shfrytëzimi i listës së aprovuar nga komisioni për barëra dhe terapi që do të ndihmonte në kontrollimin më të mirë dhe administrimin e barnave;
- Përpilimin e listës së barnave për çdo ordinancë në bashkëpunim me drejtorin dhe personelin e tij ndihmës;
- Implementimi i sistemit të furnizimit me sasinë e duhur të domosdoshme të barnave dhe materialeve harxhuese si dhe monitorimi i personelit nëpër ordinancë mbi mënyrën e porositjes, përshkrimit dhe administrimit të barnave;
- Zbatim të përpiktë të rregulloreve mbi ruajtjen e barnave në vend të sigurt dhe të përshtatshëm;
- Implementimi i një sistemi efikas për mbledhjen e participimeve në përputhje me strategjinë e MSH.

KKSHPS ka nxjerrë rekomandime edhe për shëndetin publik;

- Shëndetësia publike është prioritet kryesor i kujdesit shëndetësor, që ka për qëllim: përmirësimin e gjendjes shëndetësore, marrjes së masave kundër epidemive, kontrollimit të mjedisit, eliminimin e shkaktarëve të sëmundjeve si dhe prandalimin e sëmundjeve;
- Imunizimi është masa themelore e kujdesit ndaj shëndetit publik. Në QKMF, QMF dhe ambulancë shëndetësore të komunës sonë, ky

shërbim është mjaft mirë i organizuar, është funksional cilësor dhe efektiv. Këtë më së miri e tregon shkalla e mbulimit të vaksinimit të obligueshëm e cila është 95%.

- Edukimi shëndetësor i popullatës paraqet masë themelore të kujdesit ndaj shëndetit publik që organizohet dhe zbatohet në mënyrë të rregullt në kuadër të sistemit arsimor.
- Krijimi i një ambienti fizik që do të ndihmonte në përmirësimin e shëndetit publik, në zonat urbane dhe ato rurale të komunës siç është: ngritja e cilësisë e ujit të pijshëm, krijimi i një ambienti të pastër, hedhja e mbeturinave në vende adekuate. Të gjitha këto do të krijojnë një ambient të pastër dhe të shëndoshë;
- Duhet të caktohen prioritetet dhe të identifikohen problemet, të cilat krijojnë kushte për punë të suksesshme e që kanë domethënie të madhe për shëndetin publik. Po ashtu këto prioritete do të ndihmojnë në qëndrimin, përpjekjet dhe energjinë tonë në shumicën e nevojave shëndetësore të popullatës, të komunës sonë.

Ndërkaq pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës nga çështjet sociale janë nxjerrë këto rekomandime:

- Punëtori social ka përgjegjësi që t'i kushtohet zhvillimit të njohurive objektive dhe diciplinore si dhe aftësi për identifikimin e problemeve dhe zgjedhjen e tyre;
  - Punëtori social duhet të jetë i edukuar dhe profesionalisht i ngritur për punë të suksesshme sociale dhe përkujdesje për këtë lëmi;
  - Delikuencën e të miturve;
  - Fëmijët pa kujdes prindëror;
  - Puna me fëmijët e braktisur;
  - Trajtimi i çrregullimeve në marrëdhëniet familjare
  - Duhet t'i kushtohet kujdes themelimit dhe bashkëpunimit të OJQ-ve, të cilat merren me rehabilitimin e të hendikepuarve si dhe të grupeve tjera (invalidët e luftës, fëmijët jetim, pleqtë,) etj;
  - Qendra për punë sociale duhet t'i kushtoi rëndësi të posaçme sjelljeve asociale, delikuentëve, ushtrimit të dhunës në familje e shumë probleme tjera që më parë nuk kanë qenë të pranishme si dukuri në shoqërinë tonë.

Lektore:

---

Vlora Krasniqi

Kryesuesi i KKSHPS

---

Mr.sc.Hamit Xhaferi

